

Bibël për fëmijët
paraqet

Jezusi Shëron të Verbërin



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Janie Forest

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi


Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

©2013 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Bartimeu ishte një njeri i verbër, që ulej anës rrugës që të çonte në Jeriko, për të lypur. Disa njerëz zemërmirë i jepnin kush ndonjë monedhë të vogël, kush ndopak ushqim ndërsa kalonin andej. Bartimeu nuk mund të punonte sepse ai nuk shihte dot. Ai vetëm mund të lypte.



Një ditë, rruga e gjerë ishte shumë e zënë.
Bartimeu dëgjoji zhurmën e shumë këmbëve. Diçka
e pazakontë po ndodhte. Shpejt njeriu i verbër
mësoi çfarë ishte.



Jezusi i Nazaretit ishte në qytet. Turmat u mblodhën për të parë e për ta dëgjuar Atë.





“Jezus, Bir i Davidit, ki mëshirë për mua”! Përse po thërriste Bartimeu? Përse mendonte ai se Jezusi mund ta ndihmonte? Mbase ai kishte dëgjuar për të tjerët që Jezusi kishte shëruar. Disa ishin të shurdhër, disa memecë, disa të çalë - dhe disa të verbër, siç ishte ai. “Bir i Davidit ki mëshirë për mua”, thërriste e thërriste, Bartimeu. Zëri i tij tingëllonte me shpresë.






Bartimeu ishte i sigurt për një gjë. Nëse ai nuk do të gjente ndihmë tani, ai mund të mos kishte një rast tjetër. Jezusi mbase nuk do të kalonte sërish andej.





Bartimeu duhej të shkonte tek Jezusi, por njerëzit nuk lëviznin. "Shshshh", ia bënin ata, duke i thënë Bartimeut të rrinte urtë.








Por Bartmeu nuk e qepi
gojën. Ai vazhdoi të thërrasë.
Papritmas, Jezusi ndaloi! Dëgjo!
Urdhëroi që të sjellin njeriun e
verbër tek Ai! "Merr zemër",
njerëzit i thanë
Bartimeut.
"Çohu, Ai po
të thërret".



Duke hedhur tutje mantelin e tij, Bartimeu u çua dhe rendi tek Jezusi.




Jezusi e pyeti, "Çfarë do që të bëj Unë, për ty"? Si mund të ishe përgjigjur ti? A do kishe kërkuar ti shumë para ose rroba të reja të bukura? Ishte kjo, ajo çfarë kërkoj Bartimeu?




Jo, Bartimeu i verbër nuk i
kërkoj Jezusit ar ose rroba të
bukura. Ju e dini
çfarë donte
ai.



“Zot, që unë të mund të rimarr shikimin”. Bartimeu donte të shikonte. Të shihte pemët, dhe zogjtë dhe...gjithë krijimin e mrekullueshëm të Perëndisë. Ai donte të shihte që të mund të kujdesej për veten e tij dhe të mos ishte më një lypsar.



Atëherë Jezusi i tha Bartimeut: "Merre shikimin
tënd. Besimi yt të shpëtoi".



Menjëherë ai rimori
shikimin e tij dhe
ndoqi Jezusin.

E gjithë ajo
që ai mund
të thoshte
ishte

“Perëndia
është i
mrekullueshëm;
Ai, më shëroi
mua"! Ishin çaste
të mrekullueshme
për Bartimeun.





Të gjithë njerëzit,
kur e panë, i dhanë
lavdinë Perëndisë. Edhe
njëherë, ata kishin parë
fuqinë e mrekullueshme
të Jezusit, Birit të
Perëndisë, që i kishte
dhënë shikimin
një lypsari
të verbër e
varfanjak.



Jezusi Shëron të Verbërin

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Markut 10, Llukës 18, Gjonit 9

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

